



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 10/1Prot.

Tiranë, më 06.01.2020

V E N D I M

Nr. 4, Datë 06/01/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 83, datë 17.07.2019, e Z. A. D.dhe Znj. L. D., ku pretendohet për diskriminim të vajzës së tyre G. D. Duka, për shkak të *“aftësisë së kufizuar” dhe “peshës trupore”*, nga ana e Shkollës “Koreografike”, Tiranë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban ankesa, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur saj, rezulton se G. D. është një fëmijë 11 vjeçare, me aftësi të kufizuara dhe me nevojë për kujdes të vazhdueshëm të familjarit, pasi ka lindur me Sindromën Down². G. D. arsimohet pranë Shkollës 9-vjeçare “Ahmet Gashi”, në Laprakë, Tiranë, ku ndodhet nën kujdesin dhe asistencën e një mësuesi ndihmës. Prej një viti e gjysëm, G. D. ndjek një kurs privat baleti dhe ka marrë pjesë në disa aktivitete dhe shfaqje të organizuara nga mësuesit e këtij kursi.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Referuar Vertetimit nr. 469, datë 08.09.2017, të lëshuar nga DRSSH Dibër;

Në kushtet kur, fëmija e tyre e ka me pasion artin e baletit, prindërit e G. D. kanë kontaktuar me drejtuesen e Shkollës së Baletit, për të marrë informacion mbi kriteret dhe procedurat që ndiqen për pranimin e nxënësve në këtë shkollë. Në takimin e zhvilluar në datën 21 maj 2019 me drejtuesen e këtij institucioni arsimor, prindërit e fëmijës u vunë në dijeni të faktit, se në datën 31 maj 2019, do të zhvillohej një konkurs për pranimin e nxënësve të rinj në këtë shkollë. Prindërit e fëmijës pretendojnë se titullarja e këtij institucioni reflektoi sjellje dhe shprehje, të cilat nënkuptonin mungesën e dëshirës së saj, që G. D. të merrte pjesë në audicion. Ky fakt ndikoi në krijimin e bindjes se vajza e tyre nuk kishte shanse të barabarta me të tjerët, që do të konkurronin për në Shkollën e Baletit. Pas këmbënguljes së prindërve, G. D. arriti të merrte pjesë në audicion, por nuk u shpall fituese. Prindërit e fëmijës pretendojnë se pesha e G. D. rezultoi si kriter përjashtues për të, edhe pse ata theksojnë faktin se titullarja e Shkollës së Baletit i kishte informuar paraprakisht, se të gjithë fëmijëve u jepej mundësi e barabartë, pavarësisht peshës trupore dhe se kjo e fundit nuk konsiderohej si kriter rigoroz apo vendimtar për pranimin në Shkollën e Baletit, pasi pesha e tepërt, trupore, do të eliminohej gradualisht me kalimin e kohës.

Prindërit e G. D. theksojnë faktin se gjatë takimit me drejtoreshën e Shkollës së Baletit, biseda nuk u orientua drejt ndihmës që i duhej dhënë fëmijës së tyre, për të marrë pjesë në konkurim, por biseda u fokusua më tepër tek mungesa e aftësisë së saj, për të qendruar në klasë me orë të zgjatura, apo në përkeqësimin e situatës së saj, nëse do të ndiqte këtë shkollë të profilizuar.

Prindërit e fëmijës sqarojnë se G. D. u shoqërua në ambientet e Shkollës së Baletit nga motra e saj, në ditën, kur u zhvillua audicioni, pasi nuk lejohej prania e prindërve. Ata pretendojnë se pas shqetësimit të shprehur nga titullarja e institucionit arsimor, motra e G. D. hoqi dorë nga shoqërimi i mëtejshëm i saj. Ata shprehen se fëmijët që skualifikoheshin dilnin jashtë ambienteve të shkollës, ndërkohë që G. D. u mbajt brenda këtyre ambienteve, fakt që i bëri ata të mendonin se ajo kishte fituar. Vetëm në vijim, prindërit u informuan se G. D. nuk ishte kualifikuar, por ishte mbajtur brenda ambienteve të Shkollës së Baletit me justifikimin *“e lamë që të kënaqej vetë”*. Një fakt i tillë konsiderohet nga ana e tyre si tepër fyes dhe denigrues për vajzën e tyre.

Pas përfundimit të audicionit, G. D. nuk rezultoi fituese, pasi u cilësua mbi peshë. Pavarësisht se prindërit e fëmijës i vunë në dukje drejtoreshës së Shkollës së Baletit, faktin që u ishte bërë i ditur paraprakisht nga ajo, se kriteri i peshës nuk ishte vendimtar në përzgjedhjen e fëmijës për të ndjekur këtë shkollë, ata pretendojnë se titullarja e këtij institucioni arsimor nuk reagoi dhe nuk ktheu përgjigje.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 83, datë 17.07.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1110/1, datë 19.07.2019, Drejtores së Shkollës “Koreografike” Tiranë dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ankuesve, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Informacion mbi kriteret, që duhen plotësuar, për të ndjekur Shkollën e “Koreografike”, si dhe akti administrativ, që ka miratuar këto kriteret;
 - Informacion nëse ekzistojnë kriteret përjashtuese, për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të ndjekur këtë shkollë;
 - Informacion mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që kanë fituar audicionin dhe ndjekin aktualisht Shkollën e “Koreografike”;
 - Informacion mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që kanë ndjekur Shkollën “Koreografike”, 5 vitet e fundit;
 - Informacion mbi kriteret, që nuk plotësoi G. D. Duka, të cilat sollën si rrjedhim skualifikimin e saj në audicionin e zhvilluar në datën 31 maj 2019;
 - Informacion mbi numrin e përgjithshëm të fëmijëve, që morën pjesë në audicionin e datës 31.05.2019, si dhe të depozitohet pranë Komisionerit, një kopje e listës së fëmijëve fitues në këtë audicion;
 - Kopje e procesverbalit të mbajtur në audicionin e datës 31.05.2019, apo të aktit administrativ, ku rezulton mendimi me shkrim, i mësuesve vlerësues, për fëmijët që morën pjesë në audicion;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1110/1, datë 19.07.2019, së Komisionerit, Shkolla “Koreografike”, Tiranë dërgoi shkresën nr. 171, datë 15.08.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se çështja e G. D. Dukës nuk është shpjeguar në mënyrë korrekte nga prindërit e saj.

Në shkresën e sipërpërmendur sqarohet se në Shkollën “Koreografike”, që prej formimit të saj, nxënësit janë pranuar në bazë të disa kriterëve specifike të caktuara nga MAS, duke mos përfshirë në të nxënës me aftësi të kufizuara, për vetë profilin e specifikën e kësaj shkolle. Në Shkollën “Koreografike”, nxënësit punojnë në grup, ndryshe nga puna që zhvillohet në shkolla të tjera, për efekt të specifikave që paraqet natyra e veçantë e kësaj shkolle. Përfshirja në grup e fëmijëve me specifika e sindroma të caktuara e bën të pamundur punën në grup.

Titullarja e këtij institucioni arsimor thekson faktin se e ka trajtuar me sensibilitet të veçantë rastin e fëmijës G. D. dhe i ka sqaruar me shumë kujdes prindërit e saj, të cilëve u është bërë e ditur se fëmija do të lejohet të hyjë në konkurs, megjithëse matjet antropometrike e skualifikonin atë në rastin më të parë. Pas kësaj, G. D. u paraqit para Komisionit të Vlerësimit, duke e lejuar atë të vazhdojë konkursin deri në fund. Në vijim, G. D. u skualifikua nga Komisioni përkatës, i cili vlerësoi se vajza nuk mund të ishte pjesë vijuese e konkursit, pasi konkursi i dytë që zhvillohet në përfundim të klasës së katërt, (për të formuar klasën e pestë), ishte i pamundur të arrihej nga G. D., për shkak të vështirësive teknike.

Prindërve të G. D.s iu është bërë i ditur ky proces dhe u janë shpjeguar me shumë kujdes vështirësitë reale. Ata ranë dakord në parim me vendimin e shkollës. Shkolla “Koreografike” paraqet specifika të veçanta teknike dhe kërkon disiplinë, e njëkohësisht kërkon përqendrim mental e fizik. Megjithë vullnetin dhe dëshirën e mirë për ta ndihmuar e përkrahur fëmijët me sindromën down, G. D.A. D.nuk u pranua nga Komisioni.

Bashkëlidhur shkresës së Shkollës Koreografike, është dërguar lista “*Kriteret kryesore për vlerësimin e nxënësve në konkurs për klasën e 4-t*”, ku janë listuar kriteret përkatëse.

2. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet **në datën 24.10.2019, ora 12:00**, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore morën pjesë prindërit dhe motra e G. D., Drejtoresha e Shkollës Koreografike dhe mësuesja e baletit J.E.Gj., si dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila depozitoi aktin Autorizim nr. 8279, datë 23.10.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pala ankuese parashtroi edhe një herë në seancë pretendimet e saj, për diskriminim të vajzës së tyre me aftësi të kufizuara nga ana e Shkollës Koreografike. Prindërit e G. D. u shprehën se vajza e tyre 11

vjeçare është me sindromën down, por pavarësisht kësaj pasioni i saj është baleti. Për këtë arsye, prindërit e G. D. e kanë angazhuar atë prej 1.5 vitesh në një kurs privat baleti. Prindërit e saj sqaruan se për të ndjekur dëshirën dhe pasionin e vajzës së tyre dëshironin që ajo të ndiqte Shkollën Koreografike. Për këtë arsye, ata kishin marrë takim me Drejtoreshën e kësaj shkolle. Në takim, titullarja e Shkollës Koreografike kishte sqaruar se G. D. ishte rasti i parë i një fëmije me aftësi të kufizuara, që kërkon të regjistrohet në Shkollën Koreografike dhe se kjo shkollë nuk kishte kushte në përshtatshmëri me gjendjen e G. D.. Njëkohësisht, gjatë këtij takimi ata u informuan se G. D. duhet të kalonte konkursin përkatës, për t'u regjistruar në Shkollën Koreografike, si dhe ranë dakord me Drejtoreshën e Shkollës, që vajza të merrte pjesë në këtë konkurs. Ditën e konkursit, prindërit e G. D. nuk u lejuan të kishin akses brenda ambienteve ku do të zhvillohej konkurimi, pasi ky ishte rregull që u zbatua për të gjithë prindërit e fëmijëve konkurues. Pas përfundimit të konkursit, G. D. nuk doli nga salla, fakt që i bëri prindërit e saj të mendonin dhe shpreson se vajza e tyre e kishte fituar të drejtën për të ndjekur Shkollën Koreografike, ndërkohë që kishte ndodhur e kundërta. Në vijim, Drejtoresha e Shkollës Koreografike i njoftoi se G. D. nuk e kishte fituar konkursin kualifikues, për të ndjekur këtë shkollë.

Drejtoresha e Shkollës Koreografike sqaroi se shkolla të cilën ajo e drejtonte prej disa vitesh, është një shkollë me cikël të mbyllur dhe e vetme në llojin e saj. Nxënësit që pranohen në këtë shkollë fillojnë të ndjekin ciklin e ulët që nga klasa e katërt, ndërkohë që edhe në klasën e pestë bëjnë një konkurs të dytë. Mënyra e funksionimit të Shkollës Koreografike përcaktohet nëpërmjet Udhëzimit nr. 14, datë 12.05.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *“Për përcaktimin e kiterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”*. Sipas këtij Udhëzimi, kriteret e pranimit në këtë shkollë hartohen nga vetë shkolla, ndërkohë që theksoi faktin se kjo shkollë për vetë natyrën e saj, specifike funksionon në mënyrë të ndryshme në krahasim me shkolla të tjera. Shkolla Koreografike funksionon sipas një ndarjeje në dy klasa të veçanta për djem dhe për vajza, ku 1 mësues mbulon 15 nxënës. Nxënësit që vazhdojnë këtë shkollë i nënshtrohen një rregjimi të fortë, prej 10 orësh mësimore pothuajse çdo ditë, si dhe puna në grup është tepër e rëndësishme, për mënyrën se si realizohet mësimi i baletit në secilën klasë. Drejtoresha e Shkollës Koreografike theksoi faktin se rasti i G. D. ishte i pari, që një fëmijë me aftësi të kufizuara, kërkonte të ndiqte këtë shkollë. Ajo sqaroi se është tepër e vështirë, që G. D. të punonte në grup, si dhe t'i nënshtrohej rregjimit tepër të rreptë mësimor, të cilin detyrimisht e ndiqnin të gjithë nxënësit e tjerë. E pyetur se cilat ishin kriteret, që nuk kishte plotësuar G. D., për të mos u pranuar në këtë shkollë, Drejtoresha e Shkollës Koreografike u shpreh disa herë se kriteri i parë të cilin ajo nuk plotësonte kishte të bënte pikërisht me aftësinë e saj të kufizuar, nga e cila derivonin disa probleme të tjera që kishin të bënin me përqendrimin etj. Ajo u shpreh se nuk ekziston asnjë bazë ligjore, që parashikon ndjekjen e Shkollës Koreografike nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Disa nga kriteret që G. D. nuk plotësonte për t'u pranuar në

shkollën Koreografike kishin të bënin me çështjen e përqendrimit të saj, mungesën e gjallërisë së perceptimit etj., ndërkohë që Drejtoresha e Shkollës Koreografike u shpreh se G. D. u dallua gjatë konkurimit për elasticitetin e saj të mirë. Në seancë, ajo sqaroi gjithashtu se ka edhe shumë fëmijë të tjerë, të cilët edhe pse nuk ndodhen në kushtet e G. D. nuk janë pranuar në shkollën e baletit, pasi nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u bërë balerinë. Ajo theksoi faktin se fëmijët dystabanë apo fëmijët me skoljozë nuk pranohen për të ndjekur këtë shkollë. Ndërkohë që, theksoi faktin se pesha e tepërt trupore nuk ishte faktor penalizues për konkurentët, pasi mund të reduktohej dhe të ndryshonte me kalimin e kohës. Drejtoresha u shpreh se Shkolla Koreografike do të ndikonte negativisht tek G. D., pasi kjo e fundit nuk zotëronte kapacitetin e duhur mendor e fizik, për të përballuar rregjimin e kësaj shkolle. Zhargoni mësimor i përdorur në Shkollën Koreografike është në gjuhë të huaj dhe G. D. do të kishte shumë vështirësi për të kuptuar apo për t'u përshtatur me të tjerët.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit u shpreh se pranimet e nxënësve në Shkollën Koreografike bëhen sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 14, datë 12.05.2015, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "*Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar*". Ajo u shpreh se G. D. nuk ishte skualifikuar për shkak të aftësisë së saj të kufizuar, por si pasojë e mosplotësimit të kriterëve të vendosura nga Shkolla Koreografike dhe në këndvështrimin e saj nuk kishte diskriminim.

Ndërkohë që, prindërit e G. D.s theksuan faktin se vajzës së tyre i duhej dhënë një mundësi për të ndjekur Shkollën Koreografike. Në rast se kjo mundësi nuk do të rezultonte e suksesshme, atëherë ajo mund të skualifikohej në fazën e dytë.

Në përfundim të seancës, Komisioneri kërkoi informacion të mëtejshëm nga Shkolla Koreografike, sikurse edhe nga pala ankuese.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri dërgoi në adresë të Shkollës Koreografike shkresën nr. 1110/4, datë 19.11.2019, nëpërmjet së cilës kërkoi informacionin e mëposhtëm:

- Informacion mbi numrin e fëmijëve, që kanë konkuruar për të ndjekur Shkollën Koreografike, për këtë vit shkollor;
- Informacion mbi numrin e fëmijëve të skualifikuar pas audicionit të zhvilluar;
- Informacion mbi numrin e fëmijëve, që kanë fituar audicionin dhe ndjekin këtë vit shkollor pranë Shkollës Koreografike;
- Informacion i hollësishëm mbi kriteret, që nuk plotësoi G. D., të cilat sollën si pasojë skualifikimin e saj në audicionin e zhvilluar në datën 31 maj 2019;

- Të depozitohet pranë KMD-së, procesverbalit, ku rezulton mendimi me shkrim i Komisionit Vlerësues, për G. D.;
 - Kopje e procesverbalit të mbajtur në audicionin e datës 31.05.2019, ku rezulton mendimi me shkrim, i Komisionit Vlerësues, për fëmijët, që morën pjesë në audicion.
2. Në përgjigje të shkresës nr. 1110/4, datë 19.11.2019, së KMD-së, Shkolla Koreografike dërgoi shkresën nr. 11 10/5, datë 21.11.2019, nëpërmjet së cilës informoi mbi çështjet e kërkuara nga Komisioneri.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 83, datë 17.07.2019, e Z. A. D.dhe Znj. L. D., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 83, datë 17.07.2019, e Z. A. D.dhe Znj. L. D., pretendohet për diskriminim të vajzës së tyre G. D. Duka, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” dhe “*peshës trupore*”, nga ana e Shkollës “*Koreografike*”, Tiranë. Në kushtet kur, G. D. është nën moshën 18 vjeç, prindërit e saj janë të legjitimuar të përfaqësojnë vajzën e tyre, pranë KMD-së.

Referuar akteve të depozituara në cilësinë e proves, specifikisht Vërtetimit të lëshuar nga KMCAP i PAK Mat, DRSHSSH Dibër, si dhe Vendimit nr. 584, datë 05.07.2019, të KMCAP Dibër rezulton se G. D. ka diagnozën “*Morbus Down*” dhe është përcaktuar si person me aftësi të kufizuar, që i përket grupit të dytë. G. D. arsimohet pranë Shkollës 9-vjeçare “*Ahmet Gashi*”, në Laprakë, Tiranë, ku ndodhet nën kujdesin dhe asistencën e një mësuesi ndihmës.

Në kushtet kur, G. D. 11 vjeçare e ka pasion baletin, si dhe është e aktivizuar në një kurs privat baleti prej mëse 1 viti e gjysëm, prindërit e saj kanë mbështetur dëshirën e fëmijës për të vazhduar Shkollën Koreografike, Tiranë. Pas takimit paraprak me drejtoreshën e Shkollës Koreografike, Tiranë, e cila u vu në dijeni të aftësisë së kufizuar të vajzës, u ra dakord që G. D. të marrë pjesë në audicionin e pranimit, për vitin e ri shkollor.

Në datën 31.05.2019 është zhvilluar audicioni për pranimin dhe përzgjedhjen e nxënësve të klasës së katërt në Shkollën Koreografike, Tiranë, për vitin shkollor 2019-2020. Referuar akteve dhe dokumentacionit të dërguar nga kjo shkollë, rezulton se pjesëmarrës në konkurrim kanë qenë

40 fëmijë nga shkolla të ndryshme të Tiranës, nga të cilët 28 kanë fituar të drejtën për të ndjekur Shkollën Koreografike, ndërsa 12 fëmijë të tjerë kanë rezultuar jo fitues. Ndër 12 fëmijët që janë shpallur jo fitues, bën pjesë edhe G. D.

Sikurse rezultoi gjatë hetimit administrativ të ankesës nr. 83, datë 17.07.2019, G. D. është fëmija e parë me aftësi të kufizuara, që merr pjesë në një audicion pranimit për në Shkollën Koreografike. Në kushtet kur, G. D. rezultoi jo fituese në audicionin e zhvilluar në datën 31.05.2019, prindërit e saj pretendojnë se skualifikimi i saj është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me aftësinë e saj të kufizuar dhe peshën e saj trupore, pasi në takimin e realizuar paraprakisht me drejtoreshën e kësaj shkolle, këto kanë qenë dy elementët, që janë vënë në dukje nga ana e saj.

Shkolla Koreografike është një shkollë me arsim të orientuar. Kriteret dhe procedurat për pranimin e nxënësve në këtë shkollë përcaktohen në Udhëzimin nr. 14, datë 12.05.2015, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”*. Duke analizuar aktin e mësipërm nënligjor rezultoi se de jure nuk ekziston asnjë pengesë apo kufizim për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të ndjekur shkollat me arsim të orientuar. Referuar pikës 4, gërma d), të këtij Udhëzimi, aplikantët duhet të dorëzojnë dosjen individuale me dokumentet për aplikim, ku raporti mjekësor i lëshuar nga qendra shëndetësore është një dokument që kërkohet vetëm në rastet, kur aplikohet në shkolla sportive.

Mbështetur në pikën 1, të Kreut 3, të këtij Udhëzimi përcaktohet se në shkollat artistike dhe sportive, nxënësit pranohen me konkurs. Në pikën 3, të këtij Kreu parashikohet se: *“Kriteret e pranimeve të reja dhe dokumentacioni për konkurim, përcaktohen nga shkollat përkatëse dhe miratohen nga njësitë arsimore vendore”*. Ndërkohë që, pika 8, e Kreut 3, të këtij Udhëzimi përmban parashikim specifik për Shkollën Koreografike, si vijon: *“Në shkollën koreografike nxënësit pranohen mbi bazën e përzgjedhjes së bërë në klasat përgatitore (dy klasa të katërta). Përzgjedhja e nxënësve bëhet nga Komisioni i ngritur për këtë qëllim. Kriteret e përzgjedhjes së nxënësve përcaktohen nga shkolla dhe miratohen nga Drejtoria Arsimore Rajonale. Proçesi i konkurimit monitorohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”*.

Kriteret kryesore për vlerësimin e nxënësve në audicionin që u zhvillua për Shkollën Koreografike, për vitin 2019-2020, mbështetur në shkresën nr. 132, datë 10.04.2019, të kësaj shkolle, janë si vijojnë: *“Për përzgjedhjen e nxënësve për të qenë pjesë e shkollës Koreografike, komisioni i ngritur vlerëson:*

1. Zhvillimin proporcional të trupit.

2. Aftësinë motorike dhe kinetike.
3. Formën e duhur të këmbëve.
4. Vivortna.
5. Amplitudën e duhur të tendinës së Akilit (plié).
6. Shahun (ngritjen e lehtë të këmbëve lart).
7. Formën e shputës së këmbës (padjoni, lëvizshmëria e shputës dhe formës së gishtave).
8. Thyerjen dhe elasticitetin.
9. Aftësinë për t'u rrotulluar.
10. Muzikalitetin dhe ritmin;
11. Të qëniet skenik;
12. Kërçyeshmërinë (koordinimin);
13. Gjallërinë e perceptimit (emocionet, intelekti, ecuria në lëndët e përgjithshme);
14. Shëndetin;
15. Pasionin dhe dashurinë për profesionin, dëshira për të mësuar.”

Në mbështetje të pikës 9, të Kreut 3, të këtij Udhëzimi ku parashikohet: “Në përfundim të procesit, komisioni harton procesverbalet, të cilët janë të veçantë për secilin specialitet. Në këtë procesverbal përfshihet lista e kandidatëve të renditur sipas rezultateve”, Komisioneri kërkoi të administronte procesverbalet e audicionit të zhvilluar në datën 31.05.2019, për pranimet e reja në Shkollën Koreografike, për vitin 2019-2020, listën e pjesëmarrësve, si dhe listat e aplikantëve fitues dhe jo fitues në këtë audicion.

Mbështetur në proçeverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit, për G. D., në ditën e audicionit të pranimit, rezultoi si vijon:

“Për përzgjedhjen e nxënësve për të qenë pjesë e shkollës Koreografike, Komisioni i ngritur vlerëson nxënësin G. D.:

1. Zhvillimin proporcional të trupit. – **me bazë të gjerë;**
2. Aftësinë motorike dhe kinetike – **pjesa e sipërme e kufizuar;**
3. Formën e duhur të këmbëve – **mesatare;**
4. Vivortna –**en dekors;**
5. Amplitudën e duhur të tendinës së Akilit (plié) – **me plië normale;**
6. Shahun (ngritjen e lehtë të këmbëve lart) – **pa shah të zhvilluar;**
7. Formën e shputës së këmbës (padjoni, lëvizshmëria e shputës dhe formës së gishtave) –**pa padjom;**
8. Thyerjen dhe elasticitetin – **me elasticitet;**

9. Aftësinë për t'u rrotulluar – pa aftësi për t'u rrotulluar;
10. Muzikalitetin dhe ritmin – pa muzikalitet;
11. Të qëniet skenik – jo skenik;
12. Kërçyeshmërinë (koordinimin)- pa koordinim;
13. Gjallërinë e perceptimit (emocionet, intelekti, ecuria në lëndët e përgjithshme)- mungesë perceptimi dhe përqendrimi;
14. Shëndetin – me shëndet;
15. Pasionin dhe dashurinë për profesionin, dëshira për të mësuar- pa emocion”.

Për sa më sipër, në referencë të vlerësimit të kryer nga Komisioni i Shkollës Koreografike, i përbërë prej 7 anëtarësh, pas performimit në audicion të G. D., rezulton se ajo nuk përmbush një pjesë të konsiderueshme të kriterëve të vendosura nga kjo shkollë. Si pasojë e këtij vlerësimi, G. D. është skualifikuar, sikurse edhe 11 pjesëmarrës të tjerë në këtë audicion, të cilët nuk ishin me aftësi të kufizuar.

Parashikimi i pikës 4, të Kreut 4, të Udhëzimit nr. 14, datë 12.05.2015, i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar” iu njehtë drejtën nxënësve të drejtën e ankimit ndaj rezultatit të konkursit, jo më vonë se 3 ditë nga shpallja e rezultateve të tij. Ankimi bëhet me shkrim dhe dorëzohet ne DAR⁴. Një përfaqësues i DAR dhe Komisioni i konkurimit shqyrtojnë ankimin dhe njoftojnë me shkrim ankimuesin për vendimin. Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se pala ankuese nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë ndaj rezultatit dhe vlerësimit të Komisionit të Pranimit, për audicionin e zhvilluar, pranë Shkollës Koreografike, për vitin shkollor 2019-2020.

Nga analiza e mësipërme rezulton se G. D. nuk i është mohuar e drejta e pjesëmarrjes në audicion, si dhe është vlerësuar sipas të njëjtave kriterë të përcaktuara nga Shkolla Koreografike, sikurse të gjithë konkurentët e tjerë. Përveç G. D., janë skualifikuar edhe 11 fëmijë të tjerë, të cilët nuk kanë aftësi të kufizuar, por sipas vlerësimit të Komisionit të Pranimit, nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga kjo shkollë.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: 1. Çdo veprim ose mosveprim i

⁴Mbështetur në VKM nr. 99/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, strukturat përkatëse janë Zyrat Arsimore Rajonale.

autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”, Komisioneri gjykon se G. D. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga Shkolla Koreografike.

Pavarësisht sa më sipër, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se pavarësisht se, G. D. nuk iu mohua e drejta për të marrë pjesë në audicionin e pranimit për Shkollën Koreografike, për vitin shkollor 2019-2020, si dhe procesi i vlerësimit të saj mbështetej mbi të njëjtat kriterë, sikurse edhe për pjesëmarrësit e tjerë, sërish aftësia e saj e kufizuar përbënte një element paragjykses, lidhur me mundësinë reale të fëmijës, për të përballuar vështirësitë e Shkollës Koreografike. Përfaqësuesit e kësaj shkolle nuk mund të japin gjykime mbi mundësitë e një fëmije kur nuk janë profesionistë dhe nuk mund të dalin në përfundime paragjykesë, aq më tepër kur në këtë shkollë konkuronte për herë të parë një fëmijë me aftësi ndryshe. Këto fakte rezultuan qartë gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së.

Komisioneri i tërheq vëmendjen drejtuesve të Shkollës Koreografike dhe punonjësve të saj, që të kenë një vizion më të gjerë dhe të përkushtuar për të gjithë fëmijët, që konkurojnë në strukturën e tyre, pasi me kushtet dhe me mbështetjen e duhur të gjithë munden.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se mbështetur në parashikimet e legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar, fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet t'u jepet e njëjta mundësi sikurse edhe fëmijëve të tjerë, për të marrë pjesë në konkurime apo audicione për të ndjekur shkollat publike me arsim të orientuar ose jo dhe të mos paragjykojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhur me të drejtën e tyre për të ndjekur mësimin në këto institucione arsimore.

Në mungesë të një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, nuk mund të ketë diskriminim për shkaqet e pretenduara.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 17 e 19 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si

dhe Udhëzimit nr. 14, datë 12.05.2015, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të G. D., për shkaqet e pretenduara në ankesë, nga Shkolla Koreografike, Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Shkak – aftesi e kufizuar
Fusha – arsim